



RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

**mbi hetimin në lidhje me ankesën e [REDAKTUAR]
kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës**

Nr. OMB-C-2021-05

22 shtator 2022

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Avokati i Popullit"), më 22 shtator 2022,

pasi mori në shqyrtim ankesën e lartpërmendur, në përputhje me kompetencat e tij të përcaktuara në nenin 162(11) të Kushtetutës së Kosovës, nenin 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 28 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës (RRPP") mbi krijimin e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Procedurës së Parashtrimit të ankesave para Zyrës së Avokatit të Popullit ('Procedura e Ankesave'), të miratuar nga Avokati i Popullit më 12 shtator 2018,

pas shqyrtimit të kryer, nxjerr raportin e mëposhtëm:

I. PROCEDURA PARA AVOKATIT TË POPULLIT

1. Ankesa e regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më [REDAKTUAR].
2. Në mbështetje të ankesës së tij, parashtruesi gjithashtu dorëzoi kopje të korrespondencës së kryer përmes postës elektronike nga [REDAKTUAR] deri më [REDAKTUAR], me Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS");
3. Në mbështetje të përgjigjes së tij, Prokurori i Specializuar dorëzoi gjithashtu kopje të: (1) korrespondencës së tij përmes postës elektronike të

kryer nga [REDAKTUAR] deri më [REDAKTUAR] me parashtruesin e ankesës; (2) përshkrimin të detyrave dhe përgjegjësisive të [REDAKTUAR]; (3) mesazheve të tij të shkëmbyera përmes postës elektronike me punonjës të Dhomës, në të cilat kërkohet redaktimi i emrit të parashtruesit të ankesës; (4) versionit të redaktuar publik të Urdhrit për Redaktim pas seancës së [REDAKTUAR]; (5) versionit të redaktuar publik të transkriptit të seancës së [REDAKTUAR].

4. Sipas dispozitave të pjesës 14.3 të Procedurës së Parashtrimit të Ankesave para Zyrës së Avokatit të Popullit, në trajtimin e ankesave dhe kryerjen e hetimeve, për hir të mbrojtjes së interesave legjitime të parashtruesit të ankesës ose të një pale të tretë, Zyra e Avokatit të Popullit mund ta trajtojë si konfidencial informacionin specifik të përfshirë në ankesë ose në dokumente apo materiale të tjera që i janë dorëzuar. Parashtruesi i ankesës ka konfirmuar se nuk ka kundërshtim që të bëhet i ditur identiteti i tij dhe Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë arsye bindëse për t'i trajtuar si konfidenciale të dhënat e dorëzuara nga parashtruesi i ankesës.

II. FAKTET

5. Pas shqyrtimit të korrespondencës së parashtruesit të ankesës, dokumenteve që i janë dorëzuar Avokatit të Popullit, si edhe parashtrimeve të Prokurorit të Specializuar, përfshirë dokumentet që i janë dorëzuar Avokatit të Popullit, faktet mund të përmbliidhen si vijon:

6. Parashtruesi i ankesës ka kryer detyrën e [REDAKTUAR] brenda ZPS-së nga [REDAKTUAR] deri më [REDAKTUAR].

7. Ndërmjet [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për Mbrojtjen u nxorën 16 dokumente të çështjes [REDAKTUAR], të cilat përmbanin emrin dhe emërtimin e postit të parashtruesit të ankesës, e që ishin pjesë e nxjerrjes për Mbrojtjen të mbi 1000 materialeve me emrat e të paktën 30 punonjësve aktualë dhe të mëparshëm të ZPS-së.

8. Më [REDAKTUAR], mbrojtësi i [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]), i dërgoi një mesazh elektronik ZPS-së me të cilin i kërkonte gjithë informacionin që përshkruante hollësisht arsyet e largimit nga ZPS-ja të parashtruesit të ankesës. Më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar

njoftoi [REDAKTUAR] dhe Mbrojtjen se e kundërshtonte kërkesën. Më [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] nxori një vendim gojor me të cilin rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes.

9. Më [REDAKTUAR], në [REDAKTUAR]¹, mbrojtësi, [REDAKTUAR], në çështjen gjyqësore *Prokurori kundër [REDAKTUAR]*, e pyeti prokurorin, [REDAKTUAR], nëse; *“kishte ndonjë kundërshtim që [ai] të përdorë emrin e një punonjësi të mëparshëm [REDAKTUAR]”*. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, [REDAKTUAR] deklaroi: *“Nuk kemi kundërshtim meqë është një punonjës i përparshëm”* dhe pas kësaj, emri i parashtruesit të ankesës, që ishte identifikuar publikisht si [REDAKTUAR], u përmend gjatë seancës publike.

10. Më të njëjtën ditë, [REDAKTUAR], rreth [REDAKTUAR], një anëtar i ekipit të mbrojtjes [REDAKTUAR] ([REDAKTUAR]), kërkoi të dhënat e kontaktit nga Prokurorja e çështjes ([REDAKTUAR]). Pas kësaj kërkesë, një punonjës i ZPS-së ([REDAKTUAR]) i dërgoi një mesazh parashtruesit të ankesës dhe e pyeti nëse mund t'i jepeshin Mbrojtjes të dhënat e tij personale të kontaktit. Kjo u pasua me një telefonatë ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe [REDAKTUAR], në [REDAKTUAR], gjatë së cilës parashtruesi i ankesës refuzoi shprehimisht kërkesën që të dhënat e tij personale të kontaktit t'i jepeshin mbrojtësit ([REDAKTUAR]). Pas kësaj telefonate, parashtruesi i ankesës i dërgoi një mesazh shefit të Sigurisë të ZPS-së, [REDAKTUAR], ku e informonte për refuzimin e tij dhe gjithashtu e pyeste nëse emri i tij ishte përmendur në gjykatë.

11. Në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] kontaktoi parashtruesin e ankesës dhe i tha se emri i tij ishte përmendur në gjykatë nga mbrojtësi në çështjen gjyqësore *Prokurori kundër [REDAKTUAR]*. Pas një diskutimi me parashtruesin e ankesës rreth rëndësisë që kishte për të mbrojtja e identitetit të tij, [REDAKTUAR] e siguroi se do të dorëzohej një kërkesë për redaktimin e emrit të tij në dokumentacionin [REDAKTUAR].

12. Pas kësaj bisede, [REDAKTUAR] foli me [REDAKTUAR] dhe në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] iu dërgua përmes postës elektronike një kërkesë për redaktimin e transkriptit publik.

13. Më [REDAKTUAR], në [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës u informua lidhur me vendimin e [REDAKTUAR] për miratimin e

¹ Të gjitha orët janë sipas orës së Evropës Qendrore.

redaktimeve. Urdhri për Redaktime që miratonte redaktimin e të gjitha përmendjeve të emrit të parashtruesit të ankesës në transkriptet e seancës publike të [REDAKTUAR], u nxor më [REDAKTUAR].

14. Më [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës i dërgoi një mesazh elektronik Zëvendësprokurorit të Specializuar, [REDAKTUAR], ku shprehte shqetësimet për faktin se emri i tij ishte bërë publik. Pas një bisede telefonike me [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës kërkoi që ZPS-ja të ndërmernte hapat e mëposhtëm:

- të konfirmonte me shkrim se emri i tij ishte redaktuar në transkriptin [REDAKTUAR];
- të hiqte të dhënat e tij personale nga të gjitha dosjet me të dhëna të personelit që kishte ZPS-ja, DHSK-ja dhe EULEX-i (duke përfshirë formularin e parë të aplikimit të tij në TFHS).

15. Më [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] konfirmoi redaktimin e emrit të parashtruesit të ankesës në transkriptin [REDAKTUAR], por i shpjegoi atij se të dhënat e tij personale që ndodheshin në dosjet me të dhëna të personelit që kishte ZPS-ja, DHSK-ja dhe EULEX-i, nuk mund të fshiheshin.

16. Më [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës i dorëzoi Avokatit të Popullit këtë ankesë kundër ZPS-së. Avokati i Popullit, në përputhje me rregullën 29(2)(a) të RRPP-së, filloi shqyrtimin paraprak të ankesës.

17. Më [REDAKTUAR], në përputhje me pjesën 7.1 të Procedurës së Parashtrimit të Ankesave, Avokati i Popullit kërkoi informacion shtesë nga parashtruesi i ankesës në lidhje me ankesën. Më [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës i dorëzoi Avokatit të Popullit përgjigjen.

18. Më [REDAKTUAR], në përputhje me pjesët 9.3 dhe 9.4 të Procedurës së Parashtrimit të Ankesave, Avokati i Popullit njoftoi Prokurorin e Specializuar për ankesën dhe kërkoi mendimin e tij si organ kundër të cilit ishte paraqitur ankesa. Avokati i Popullit kërkoi mendimin e Prokurorit të Specializuar lidhur me pranueshmërinë dhe themelësinë e ankesës dhe i vuri në dispozicion ankesën dhe dokumentet shoqëruese. Më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar i dorëzoi përgjigjen Avokatit të Popullit, e cila përmbante pikëpamjet e tij lidhur me pranueshmërinë dhe themelësinë e ankesës.

19. Më [REDAKTUAR], parashtrimi i Prokurorit të Specializuar iu vu në dispozicion parashtruesit të ankesës, të cilit, në përputhje me pjesët 9.3 dhe 9.4 të Procedurës së Parashtrimit të Ankesave, iu dha mundësia të shprehte pikëpamjet e tij [REDAKTUAR]. Më [REDAKTUAR], pas kërkesës së dorëzuar nga parashtruesi i ankesës, u miratua një shtyrje prej 30 ditësh për dhënien e përgjigjes. Më [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës dorëzoi përgjigjen, e cila përmbante pikëpamjet e tij lidhur me parashtrimin që Prokurori i Specializuar i kishte dorëzuar Avokatit të Popullit.

20. Më [REDAKTUAR], në përputhje me pjesët 9.3 dhe 9.4 të Procedurës së parashtrimit të ankesave, Avokati i Popullit ia dha këtë përgjigje Prokurorit të Specializuar dhe kërkoi të dinte qëndrimin e tij në lidhje me të. Më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar dorëzoi përgjigjen. Më [REDAKTUAR], në përputhje me pjesën 7.1 të Procedurës së Parashtrimit të Ankesave, Avokati i Popullit kërkoi informacion shtesë nga Prokurori i Specializuar. Më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar dorëzoi përgjigjen e tij dhe dha informacion shtesë.

III. ANKESA

21. Parashtruesi i ankesës pretendon se, së pari, emri i tij u nxor në sallën e gjyqit, në gjykimin e çështjes së [REDAKTUAR]. Së dyti, ai pretendon se emri i tij nuk u redaktua në dokumentet që ishin nxjerrë për Mbrojtjen. Ai pretendon se kjo u bë pa e kontaktuar paraprakisht atë dhe pa i dhënë mundësinë që të kundërpërgjigjej në proces. Parashtruesi i ankesës pretendon se nxjerrja e emrit të tij në sallën e gjyqit dhe në dokumentet që i ishin dhënë Mbrojtjes ndikoi në privatësinë e tij, rrezikoi sigurinë e tij dhe të tjerëve për shkak të rolit specifik konfidencial që ai kishte luajtur në kuadër të ZPS-së. Parashtruesi i ankesës gjithashtu pretendon se kjo nxjerrje ka ndikuar negativisht në mundësinë që ai të punojë në të njëjtën fushë në të ardhmen.

IV. DISPOZITAT LIGJORE

22. Sipas rregullës 29(2)(a) të RRPP-së, Avokati i Popullit mund të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej cilitdo personi që pretendon shkelje të të drejtave nga Dhomat e Specializuara ('DHS') ose nga ZPS-ja. DHS-ja dhe ZPS-ja kanë detyrimin të veprojnë në përputhje me të drejtat e

mishëruara në Kushtetutë dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të parapara në të njëjtin instrument, ndër të cilat Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ')² dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)³. Këto instrumente janë të detyrueshme si për DHS-në, ashtu edhe për ZPS-në.

23. Rregulla 28(2) e RRPP-së përcakton kuadrin e juridiksionit të Avokatit të Popullit i cili përfshin vetëm monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

24. Sipas nenit 162(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta e Kosovës' ose 'Kushtetuta')⁴, DHS-ja dhe ZPS-ja duhet të veprojnë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Konkretisht, në këtë dispozitë theksohet se të dy institucionet *"do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55.*

25. Në bazë të së drejtës materiale, Avokati i Popullit ka kompetencë të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Rrjedhimisht, KEDNJ-ja, KNDCP-ja dhe Kushtetuta e Kosovës kanë rëndësi të veçantë për punën e Avokatit të Popullit sepse përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar nga autoritetet publike në një shoqëri demokratike.

a. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

26. Neni 36 i Kushtetutës së Kosovës përcakton të drejtën e përgjithshme të privatësisë për individët:

27. Neni 36(1) i Kushtetutës, i cili ka të bëjë me të drejtën e respektimit të jetës private, parashikon se *"çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private*

² Council of Europe, European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, as amended by Protocols Nos. 11 and 14 (4 November 1950), ('ECHR').

³ UN General Assembly International Covenant on Civil and Political Rights (16 December 1996), UN Treaty Series Vol. 999 ('ICCPR').

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008, (me ndryshimet e vitit 2020).

dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera”.

28. Në nenin 36(4) thuhet se *“secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj”.*

29. Neni 25(1) i Kushtetutës së Kosovës përcakton se *“secili individ gëzon të drejtën për jetën”.*

b. E drejta përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

30. Ritheksohet se Kapitulli II i Kushtetutës nënvizon zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të disa instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndër të cilët KEDNJ-ja me Protokollet e saj dhe KNDCP-ja.

31. Neni 8(1) i KEDNJ-së përcakton se *“çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij”.*

32. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (‘GJEDNJ’), e cila interpreton KEDNJ-në, e ka zbatuar nenin 8 në fushën e punësimit dhe në ushtrimin e veprimtarive profesionale dhe afariste”.⁵

33. Gjithashtu, me rëndësi është edhe neni 17 i KNDCP-së në të cilin thuhet se:

1. Askush nuk duhet të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose letërkëmbim, e as duhet t’i shkelet nderi dhe reputacioni në mënyrë të paligjshme.

2. Secili ka të drejtë të ketë mbrojtje ligjore kundër ndërhyrjeve dhe shkeljeve të tilla.

34. Gjithashtu, neni 291) i KEDNJ-së përcakton se *“e drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj”.*

⁵ Sipas GJEDNJ-së, “kufizimet që i bëhen jetës profesionale të një individi mund të bien brenda fushëveprimit të nenit 8, kur ato ndikojnë në mënyrën se si individi formon identitetin e tij shoqëror përmes zhvillimit të marrëdhënieve me të tjerët”. *Shih, p.sh., GJEDNJ, Martínez v. Spain*, no. 56030/07, ECHR 2012, para. 109; *Özpınar v. Turkey*, no. 20999/04, ECHR 2010, para. 46; *Sidabras and Džiautas v. Lithuania*, nos. 55480/00 and 59330/00, ECHR 2015, para. 48.

35. Po ashtu, me rëndësi është dhe neni 6(1) i KNDCP-së, në të cilin thuhet se *“e drejta e jetës është e drejtë e lindur e njeriut. Kjo e drejtë duhet të mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet arbitrarisht nga jeta”*.

V. PIKËPAMJET E PARASHTRUESIT TË ANKESËS DHE TË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

a. Argumentet e paraqitura në formularin e ankesës

36. Në formularin e ankesës, të marrë më [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës paraqet këto argumente:

37. Së pari, parashtruesi i ankesës pretendon se emri i tij duhej të ishte redaktuar në materialin e nxjerrë për Mbrojtjen nga ZPS-ja, dhe se nëse për arsye specifike emri i tij ishte i rëndësishëm për çështjen gjyqësore, ai duhej të ishte kontaktuar paraprakisht dhe t'i ishte dhënë mundësia të shprehte pikëpamjet e tij në lidhje me nxjerrjen e materialeve. Ai gjithashtu ankohet se nuk ka mundësi të kundërpërgjigjet në asnjë proces që ka pasur një ndikim negativ ndaj tij.

38. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës pretendon se nxjerrja e emrit të tij i ka dëmtuar reputacionin dhe ka komprometuar sigurinë e tij dhe të tjerëve, duke pasur parasysh rolin konfidencial që ai ka patur.

b. Përgjigja e parashtruesit të ankesës ndaj kërkesës për informacion shtesë

39. Në përgjigjen e tij të [REDAKTUAR] ndaj kërkesës së Avokatit të Popullit për informacion shtesë, parashtruesi i ankesës paraqiti këto argumente shtesë:

40. Parashtruesi i ankesës pretendon se përmendja e emrit të tij në seancë publike do të thotë se emri i tij mund të dëgjohej nga ata që ndiqnin transmetimin në ditën që u përmend emri. Në këtë kuptim, ai thekson se me sa kupton ai nga procedurat gjyqësore, punonjësit në detyrë [REDAKTUAR] të ZPS-së përmenden vetëm me titujt e tyre të vendit punës.

41. Në këtë aspekt, ai pretendon se nxjerrja e emrit të tij mund të kishte qenë veçanërisht e dëmshme, duke pasur parasysh rolin e tij të mëparshëm për ZPS-në, [REDAKTUAR]. Gjithashtu, ai pretendon se për shkak të funksionit të tij të veçantë, identiteti i tij duhej të ishte mbrojtur, përndryshe [REDAKTUAR] nuk do të kishte shumë kuptim.

42. Po ashtu, parashtruesi i ankesës pretendon se Prokurori i Specializuar nuk ishte në dijeni të detajeve të rrethanave të tij aktuale personale, siç ishte mundësia që ai të kthehej në fushën e [REDAKTUAR], dhe se përmendja e emrit të tij në seancë publike mund të kishte sjellë si rezultat tërheqjen e tij nga çdo rol i tillë. Gjithashtu, përmendja e emrit të tij në seancë publike mund të kishte dëmtuar gjithashtu çdo perspektivë punësimi në fushën e [REDAKTUAR] në të ardhmen.

43. Parashtruesi i ankesës pretendon gjithashtu se vetëm ndërhyrja e tij parandaloi dëmtimin e mëtejshëm të sigurisë së tij dhe familjes së tij.

c. Përgjigjja e parë e Prokurorit të Specializuar ndaj argumenteve të parashtruesit të ankesës

44. Në përgjigje të argumenteve të parashtruesit të ankesës, më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar paraqiti argumentet e mëposhtme:

45. Së pari, Prokurori i Specializuar parashtron se ZPS-ja është prokurori publike dhe se asnjë punonjës i saj logjikisht nuk mund të presë që identiteti i tij apo i saj nuk do të zbulohet asnjëherë, pasi kushdo që është i punësuar në këtë organ, në fund të fundit, jep kontribut në ndjekjet penale dhe, rrjedhimisht, identiteti i tij ose i saj mund të nxirret për Mbrojtjen dhe Gjykatën, dhe emrat të bëhen publikë.

46. Lidhur me rolin e parashtruesit të ankesës si punonjës i ZPS-së, Prokurori i Specializuar parashtron se ai ka punuar si [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Prokurori i Specializuar parashtron se parashtruesi i ankesës duhej ta kishte ditur se raportet e tij do të nxirreshin për Mbrojtjen, siç përcaktohet në RRPP.

47. Prokurori i Specializuar parashtron se hapat e ndërmarrë nga Prokurori i Specializuar në lidhje me nxjerrjen e identitetit të

parashtruesit të ankesës ishin plotësisht në përputhje me rregullat në fuqi, vendimet e [REDAKTUAR] dhe Udhëzuesit e Punës së Zyrës Administrative. Në këtë aspekt, Prokurori i Specializuar parashtron se, në bazë të rregullave 102 dhe 103 të RRPP-së, ZPS-ja duhet t'i japë Mbrojtjes të gjitha materialet përkatëse. Si rezultat, punonjësit, siç është parashtruesi i ankesës, të cilët ishin angazhuar në mbledhjen e provave, duhej të kenë ditur se ekzistonin të gjitha mundësitë që ata të jepnin dëshmi në lidhje me punën e tyre në seanca apo gjykime në DHSK. Në mbështetje të këtij argumenti, Prokurori i Specializuar parashtron se pasuesit të parashtruesit të ankesës [REDAKTUAR] iu desh të jepte dëshminë e tij në [REDAKTUAR]. Rrjedhimisht, Prokurori i Specializuar parashtron se mbrojtja e kërkuar nga parashtruesi i ankesës, punonjës i mëparshëm, do të kishte tejkaluar masat mbrojtëse që u ofrohen punonjësve aktualë, me funksione të ngjashme me ato të parashtruesit të ankesës.

48. Lidhur me dokumentet e nxjerra për Mbrojtjen, Prokurori i Specializuar parashtron se Mbrojtjes mund të mos i tregohet informacioni vetëm mbi bazën e arsytimit dhe varësisht prej miratimit të gjykatës. Prokurori i Specializuar gjithashtu parashtron se, për rrjedhojë, nuk ka një bazë të përgjithshme për mosnxjerrjen e identiteteve të punonjësve dhe se kjo gjë kuptohet nga të gjithë punonjësit e është në përputhje me Rregulloren dhe praktikën e gjykatave të tjera ndërkombëtare. Prokurori i Specializuar argumenton se Vendimi Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To [REDAKTUAR] ('Vendimi Kornizë') i lejon ZPS-së të redaktojë vetëm emrat e punonjësve që udhëtojnë rregullisht në terren ose janë të vendosur në terren, duke qenë se një nxjerrje e tillë e identitetit mund t'i rrezikojë ata ose punën e tyre. Prokurori i Specializuar parashtron se, me këto kushte, ky është një përjashtim i ngushtë dhe zbatohet vetëm për një kategori të kufizuar punonjësish aktualë e nuk zbatohet për punonjësit e mëparshëm. Sidoqoftë, Prokurori i Specializuar parashtron se edhe raportet e hartuara nga pasuesi në detyrë i parashtruesit të ankesës, janë nxjerrë pa redaktime.

49. Lidhur me nxjerrjen në publik të identiteteve të punonjësve në kontekst të procesit që është duke u zhvilluar, Prokurori i Specializuar i referohet nenit 33(3) të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-15, të datës 17 maj 2019 ('Udhëzuesi i Punës i Zyrës

Administrative'), sipas të cilit, pjesëmarrësit në procese gjyqësore udhëzohen të përmendin punonjësit duke iu referuar emërtimit të postit e jo identitetit, me përjashtim të rasteve kur kjo është tejet e domosdoshme. Në këtë aspekt, Prokurori i Specializuar parashtron se kjo dispozitë në vetvete ka të bëjë me punonjësit aktualë në detyrë.

50. Prokurori i Specializuar thekson faktin se ZPS-ja ka kërkuar masa mbrojtëse, në veçanti, pseudonime për pasuesin e parashtruesit të ankesës dhe një hetues të ZPS-së, gjatë dhënies së dëshmive të tyre [REDAKTUAR]. Kjo kërkesë u rrëzua nga [REDAKTUAR], gjë që çoi në dëgjimin e identiteteve dhe dëshmive të të dy punonjësve gjatë gjykimit publik.

51. Për sa i takon rolit të parashtruesit të ankesës gjatë kohës kur ai ishte punonjës i ZPS-së, Prokurori i Specializuar paraqet parashtrimet dhe argumentet e mëposhtme:

52. Parashtruesi i ankesës ka shërbyer si [REDAKTUAR] gjatë kohës kur ai punonte për ZPS-në. [REDAKTUAR].

53. Prokurori i Specializuar argumenton se, për rrjedhojë, parashtruesi i ankesës duhej ta kishte ditur, pra, edhe para se të largohej nga puna në ZPS më [REDAKTUAR], se raportet, autor i të cilave ishte, do të nxirreshin për Mbrojtjen në ndjekjen penale që po zhvillohej [REDAKTUAR], siç përcaktohet nga rregullat.

54. Prokurori i Specializuar parashtron se të gjithë hapat e ndërmarrë nga ZPS-ja në lidhje me identitetin e parashtruesit të ankesës ishin plotësisht në përputhje me rregullat në fuqi, vendimet e [REDAKTUAR] dhe udhëzuesit e punës të Zyrës Administrative.

55. Gjithashtu, Prokurori i Specializuar deklaron se kur parashtruesi i ankesës kërkoi më [REDAKTUAR] që emri i tij të redaktohej në transkriptin publik të [REDAKTUAR], ZPS-ja veproi menjëherë për të siguruar një urdhër të tillë [REDAKTUAR].

56. Në përgjigje të kërkesës specifike të parashtruesit të ankesës që në materialet e nxjerra të redaktohen emrat e punonjësve të mëparshëm, ose që punonjësit e mëparshëm të informohen nëse kërkohet nxjerrja e materialeve, Prokurori i Specializuar paraqet argumentet e mëposhtme.

57. Prokurori i Specializuar deklaroi se kërkesa për redaktim të plotë është në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi të kësaj gjykate për nxjerrjen e materialeve dhe transparencën e procesit.

58. Gjithashtu, Prokurori i Specializuar argumenton se, duke pasur parasysh dhjetëra punonjës të mëparshëm të ZPS-së dhe të organizatës pararendëse të saj, TFHS-së, emrat e të cilëve figurojnë në dhjetëra mijëra dokumente të nxjerra nga ZPS-ja në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të saj për nxjerrjen e materialeve, redaktimi i emrave të tyre dhe/ose kërkesa që ZPS-ja t'i kontaktonte ata do të ishte e papërligjur, jashtëzakonisht e vështirë për t'u zbatuar, padyshim do të çonte në debate të mëtejshme juridike dhe do të sillte vonesa të konsiderueshme të procesit.

59. Prokurori i Specializuar parashtron se ZPS-ja është e angazhuar të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm dhe të realizueshëm për të garantuar sigurinë e dëshmitarëve, punonjësve aktualë dhe punonjësve të mëparshëm, në rastet kur ka arsye konkrete për ta bërë këtë.

d. Përgjigjja e parashtruesit të ankesës ndaj përgjigjes së Prokurorit të Specializuar

60. Në përgjigjen e tij ndaj përgjigjes së Prokurorit të Specializuar, të datës [REDAKTUAR], parashtruesi i ankesës paraqiti argumentet e mëposhtme.

61. Së pari, parashtruesi i ankesës pranon se ai do të kishte dhënë dëshmi në çështjen [REDAKTUAR], veçanërisht në lidhje me raportet që kishte hartuar, dhe se kjo dëshmi mund të ishte publike. Sidoqoftë, ai parashtron se ka dispozita sipas të cilave dëshmia mund të jepet në seancë private, dhe identiteti i dëshmitarëve të mbrohet me mënyra të ndryshme.

62. Në lidhje me faktin se [REDAKTUAR] rrëzoi kërkesën e ZPS-së për zbatimin e masave mbrojtëse ndaj pasuesit të tij dhe një hetuesi të ZPS-së, parashtruesi i ankesës pretendon se kjo tregon moskuptimin nga Prokurori i Specializuar të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet [REDAKTUAR] dhe një hetuesi.

63. Parashtruesi i ankesës pretendon se nëse kërkesat për përdorim të pseudonimeve për [REDAKTUAR] dhe hetuesin ishin të ngjashme dhe argumentet për secilin prej tyre nuk ishin në thelb të ndryshme, atëherë kërkesa për [REDAKTUAR] ishte tërësisht e pamjaftueshme.

64. Gjithashtu, parashtruesi i ankesës pretendon se fakti që mbrojtësi i specializuar kishte bërë përpjekje për ta kontaktuar atë pas nxjerrjes së emrit të tij, tregon sa e pakujdesshme ishte treguar ZPS-ja. Ai gjithashtu pretendon se nuk duket se redaktimi i emrit të tij në dokumentet përkatëse është i vështirë.

65. Së fundi, parashtruesi i ankesës, ndonëse është mirënjohës për veprimet e ndërmarra nga ZPS-ja për të hequr emrin e tij nga dokumentacioni i procesit gjyqësor, pretendon po ashtu se pavarësisht nga rregullat e përmendura nga Prokurori i Specializuar në përgjigjen e tij, në këtë rast duhej të ishin zbatuar dispozitat e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para DHSK-së që parashikojnë mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe, rrjedhimisht, emri i tij të mos nxirrej. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo është pikërisht ajo që do të duhej të kishte ndodhur pasi ZPS-ja as nuk i dinte rrethanat e tij aktuale e as u kujdes për to, dhe atij nuk iu dha asnjë informacion paraprak se do të përmendej emri i tij.

e. Kundërpërgjigjja e Prokurorit të Specializuar ndaj përgjigjes së parashtruesit të ankesës

66. Në kundërpërgjigjen e tij të [REDAKTUAR] ndaj përgjigjes së parashtruesit të ankesës, Prokurori i Specializuar parashtron si vijon.

67. Pjesa më e madhe e përgjigjes së parashtruesit të ankesës del jashtë kuadrit të ankesës së tij. Prokurori i Specializuar vë në dukje pretendimin e parashtruesit të ankesës se kërkesa për masa mbrojtëse për pasuesin e tij, ishte, sipas tij, e mangët.

68. Prokurori i Specializuar parashtron se, në fakt, argumentet në mbështetje të masave mbrojtëse për pasuesin në detyrë të parashtruesit të ankesës i janë paraqitur [REDAKTUAR] në mënyrë të plotë, si me parashtrime me shkrim ashtu edhe me parashtrime gojore. Pas shqyrtimit të argumenteve dhe dispozitave ligjore përkatëse, [REDAKTUAR] e rrëzoi kërkesën e Prokurorisë.

69. Prokurori i Specializuar parashtron se pikëpamjet personale të parashtruesit të ankesës mbi mënyrën se si Prokuroria zhvilloi debatet juridike në këtë çështje, nuk kanë asnjë ndikim në ankesën e tij.

70. Prokurori i Specializuar parashtron se pjesa tjetër e përgjigjes së parashtruesit të ankesës nuk u jep përgjigje pikave të parashtruara në letrën e tij të [REDAKTUAR]. Prokurori i Specializuar vë në dukje kërkesën e parashtruesit të ankesës që t'i jepet një kopje e kërkesës së bërë nga Prokurori i Specializuar për redaktimin e emrit të tij në dokumentet gjyqësore publike. Prokurori i Specializuar parashtron se kjo kërkesë është bërë përmes një mesazhi elektronik dërguar [REDAKTUAR], që ishte procedura normale për kërkimin e kryerjes së redaktimeve në transkriptet publike. Prokurori i Specializuar deklaron se ky mesazh elektronik jepte hollësi për shqetësimet e lidhura me sigurinë e parashtruesit të ankesës dhe për shqetësimet që ai kishte lidhur me perspektivën e punësimit të tij në të ardhmen si [REDAKTUAR]. Kërkesa u miratua dhe emri i parashtruesit të ankesës u redaktua menjëherë në dokumentet gjyqësore publike.

f. Përgjigja e Prokurorit të Specializuar ndaj Kërkesës për Informacion Shtesë

71. Për të kuptuar më mirë pikëpamjet e Prokurorit të Specializuar, më [REDAKTUAR], Avokati i Popullit iu drejtua me shkrim Prokurorit të Specializuar, duke i kërkuar sqarim dhe informacion shtesë dhe, në lidhje me këtë, formuloi pyetje të sakta për të cilat kërkoi përgjigje nga Prokurori i Specializuar. Më [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar u përgjigj duke paraqitur parashtrimet e mëposhtme.

72. Lidhur me përmendjen e emrit të parashtruesit të ankesës në gjykatë, Prokurori i Specializuar bën të ditur se ky aspekt trajtohet në [REDAKTUAR] Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative, sipas të cilit, pjesëmarrësit në procese gjyqësore udhëzohen të përmendin punonjësit duke iu referuar emërtimit të postit e jo identitetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur kjo është tejet e domosdoshme. Prokurori i Specializuar parashtron se ndonëse, në pamje të parë, kjo dispozitë zbatohet vetëm për punonjësit aktualë, ai pajtohet se baza arsyetuese për këtë rregull mund të përfshijë edhe punonjës të mëparshëm dhe se, rrjedhimisht, në të ardhmen ZPS-ja do të angazhohet në mënyrë aktive

që punonjësit e mëparshëm të përmenden në seancat e gjyqësore publike duke iu referuar emërtimit të postit e jo emrit të tyre, përveç rasteve kur kjo është rreptësisht e domosdoshme, ose bëhet me urdhër të gjykatës. Prokurori i Specializuar argumenton se emri i parashtruesit të ankesës më pas u redaktua nga transkripti dhe nuk figuron në dokumentet publike.

73. Lidhur me përmendjen e emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet e nxjerra për Mbrojtjen, Prokurori i Specializuar parashtron se detyrimi i ZPS-së për nxjerrjen e materialeve përcaktohet në rregullat 102 dhe 103 të RRPP-së. Prokurori i Specializuar parashtron se Rregullorja kërkon nxjerrjen e të gjitha materialeve fajësuese, shfajësuese dhe relevante, duke lejuar redaktimin ose mosnxjerrjen e informacionit për Mbrojtjen vetëm në rrethana të kufizuara dhe të përcaktuara shprehimisht.

74. Në këtë aspekt, Prokurori i Specializuar parashtron se nuk ka një rregull të përgjithshëm që lejon ZPS-në të redaktojë emrat e punonjësve ose ish-punonjësve. [REDAKTUAR] Vendimit Kornizë, lejon redaktimin e emrave të punonjësve vetëm kur kjo është e domosdoshme për shkak të funksioneve të tyre, konkretisht nëse ata udhëtojnë rregullisht në terren ose janë të vendosur atje, ose nëse nxjerrja e emrave të tyre do t'i vinte ata ose punën e tyre në rrezik.

75. Prokurori i Specializuar parashtron se nuk ka ndonjë mospajtim se kjo dispozitë nuk zbatohet aktualisht në lidhje me parashtruesin e ankesës , as kur ishte i punësuar në ZPS, dhe, për rrjedhojë, sipas Rregullores thjesht nuk ka asnjë bazë për redaktimin e emrit të tij.

76. Gjithashtu, Prokurori i Specializuar vë në dukje parimet më të gjera që shtrohen për diskutim për ZPS-në. Ai deklaron se ZPS-ja është prokurori publike dhe jo organizatë e shërbimit të zbulimit dhe, rrjedhimisht, duhet të funksionojë në mënyrë të hapur dhe transparente, me disa përjashtime të kufizuara dhe të arsyetuara, gjë që është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve dhe për të siguruar që procesi të jetë i besueshëm.

77. Prokurori i Specializuar parashtron se punonjësit e ZPS-së i kuptojnë rregullat në fuqi dhe funksionin publik të organit dhe se gjithçka që ata bëjnë është objekt i nxjerrjes dhe i shqyrtimit në gjykatë.

78. Prokurori i Specializuar vë në pah faktin se këto parime ishin veçanërisht të rëndësishme [REDAKTUAR]. Prokurori i Specializuar parashtron se ZPS-ja mbajti barrën e rrëzimit të kësaj mbrojtjeje dhe këtë e bëri, pjesërisht, duke qenë transparente lidhur me funksionimin dhe hetimin e saj.

79. Lidhur me kundërshtimin e parashtruesit të ankesës ndaj kërkesës së Mbrojtjes për të marrë të dhënat e tij të kontaktit [REDAKTUAR], Prokurori i Specializuar argumenton se nuk ka asnjë mospajtim real në lidhje me këtë pikë, pasi ZPS-ja kishte qenë gjithmonë dakord që ky informacion nuk do të nxirrej pa pëlqimin e punonjësit.

80. Prokurori i Specializuar vë në pah faktin se në rastin në fjalë, parashtruesi i ankesës u kontaktua nga ZPS-ja për të parë nëse ai do të pranonte nxjerrjen e të dhënave të tij të kontaktit. Ai nuk pranoi, dhe, rrjedhimisht, të dhënat e tij nuk u nxorën.

81. Prokurori i Specializuar i kushton vëmendje faktit se kërkesa e Mbrojtjes u bë, jo për shkak të nxjerrjes së emrit të parashtruesit të ankesës në gjykatë, por sepse Mbrojtja kishte pyetje [REDAKTUAR].

82. Lidhur me kërkesën e parashtruesit të ankesës që i gjithë informacioni i tij personal në dosjet me të dhëna të personelit të ZPS-së, DHSK-së dhe EULEX-it të redaktohej, Prokurori i Specializuar parashtron se dosja e personelit e parashtruesit të ankesës është konfidenciale dhe nuk ka asnjë arsytim ose mekanizëm për fshirjen e këtij informacioni nga brenda.

83. Së fundi, lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës se nxjerrja e emrit të tij për Mbrojtjen dhe në dokumentet gjyqësore publike mund të rrezikojë sigurinë e tij dhe mundësitë për të gjetur punë në të ardhmen, Prokurori i Specializuar parashtron se ZPS-ja trajton me shumë seriozitet çdo mundësi kërcënimi për sigurinë dhe mirëqenien e çdo punonjësi aktual ose të mëparshëm. Në rastin në fjalë, Prokurori i Specializuar parashtron se nuk ka bazë për të besuar se siguria e parashtruesit të ankesës ose mundësitë e tij të punësimit në të ardhmen janë rrezikuar nga nxjerrja e emrit të tij [REDAKTUAR].

VI. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

84. Pas shqyrtimit të ankesës, Avokati i Popullit do ta trajtojë atë në dy pika të veçanta. Së pari, parashtruesi i ankesës kundërshton nxjerrjen e emrit të tij në gjykatë dhe, së dyti, ai kundërshton përfshirjen e emrit të tij në dokumentet e nxjerra për Mbrojtjen.

a. Nxjerrja e emrit të parashtruesit të ankesës në seancat gjyqësore publike

85. Në lidhje me pikën e parë të ankesës, Avokati i Popullit vëren se ndonëse parashtruesi i ankesës nuk ka përcaktuar konkretisht të drejtat themelore të cilat pretendon se janë shkelur nga ZPS-ja gjatë procesit gjyqësor, nga përmbajtja e kërkesës dhe parashtrimeve është e qartë se ankesa e tij ka të bëjë me të drejtën e tij për jetë private, të drejtën e tij për jetën dhe të drejtën e tij për jetë private dhe profesionale, të cilat mbrohen me nenet 25 dhe 36 të Kushtetutës së Kosovës, nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së dhe nenet 6 dhe 17 të KNDCP-së.

86. Sipas rregullave 29(1) dhe 29(3) (a) të RRPP-së, Avokati i Popullit nuk ndërhyr në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara, me përjashtim të rasteve në lidhje me vonesa të paarsyeshme.⁶

87. Avokati i Popullit është i mendimit se pika e parë e ankesës lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e procesit gjyqësor në çështjen *Prokurori i Specializuar kundër [REDAKTUAR]*. Mbrojtja e parashtruesit të ankesës gjatë seancës publike dhe zhvillimi i këtij procesi është çështje që i takon gjykatës.

88. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit është i mendimit se çdo problem i mundshëm që buron nga ankesa si rezultat i drejtpërdrejtë i procesit, është jashtë juridiksionit të tij. Për këtë arsye, Avokati i Popullit nuk ka juridiksion mbi këtë pikë të ankesës sepse, sipas rregullës 29(1) si dhe

⁶ Shih gjithashtu CDL-AD(2019)005 – *Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit ('Parimet e Venecias')*, Komisioni Evropian për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) (Strasburg, 2 maj 2019), para. 13 (“Kompetenca e Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin kufizohet në garantimin e efikasitetit procedural dhe funksionimit administrativ të atij sistemi”); *Vendim i Avokatit të Popullit për Mospranim të Ankesës pas Marrjes së Ankesës së Driton Lajçit kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës*, nxjerrë më 2 gusht 2021, OMB-C-2021-02, para. 36-38

rregullës 29(3) të RRPP-së, atij i ndalohet të ndërhyjë në çështje gjyqësore ose procese të tjera ligjore para Dhomave të Specializuara.

89. Avokati i Popullit vëren se, pas një kërkesë të paraqitur nga ZPS-ja, [REDAKTUAR] nxori një Urdhër për Redaktim pas seancës, që urdhëronte redaktimin e emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet publike.

b. Nxjerrja e emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet e dhëna Mbrojtjes

90. Ndonëse parashtruesi i ankesës nuk ka përcaktuar konkretisht të drejtat themelore të cilat pretendon se janë shkelur nga ZPS-ja gjatë procesit gjyqësor, nga përmbajtja e kërkesës dhe parashtrimeve është e qartë se ankesa e tij ka të bëjë me të drejtën e tij për jetë private, të drejtën e tij për jetën dhe të drejtën e tij për jetë private dhe profesionale, të cilat mbrohen me nenet 25 dhe 36 të Kushtetutës së Kosovës, nenet 2 dhe 8 të KEDNJ-së dhe nenet 6 dhe 17 të KNDCP-së.

91. Rregulla 29(3)(a) e RRPP-së e ndalon Avokatin e Popullit të ndërhyjë në procese gjyqësore. Sidoqoftë, kjo dispozitë nuk e ndalon Avokatin e Popullit të marrë dhe shqyrtojë ankesa të formuluar kundër dispozitave legjislative ose procedurave administrative që zbatohen brenda një organi të DHSK-së-ZPS-së, në rast se këto dispozita ose procedura, gjatë zbatimit nga organi në fjalë, prekin të drejtat themelore të parashtruesit të ankesës.

92. Avokati i Popullit është bindur se pika e dytë e ankesës ngre çështje që kanë të bëjnë me kornizat specifike normative dhe me mënyrën se si ZPS-ja i zbaton.

93. Rrjedhimisht, në përputhje me rregullën 29(3) të RRPP-së, Avokati i Popullit pranon pikën e dytë të ankesës.

94. Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtës së parashtruesit të ankesës për jetë private, sipas nenit 8(1) të KEDNJ-së, *“çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij”*. Megjithëse në këtë dispozitë nuk flitet për zbatimin e saj në fushën e të drejtës së punësimit dhe ushtrimit të veprimtarive profesionale dhe afariste,

GJEDNJ-ja e ka zbatuar tashmë nenin 8 në këtë fushë.⁷ GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se “ekzistojnë një sërë elementesh që janë të rëndësishme për të shqyrtuar nëse jeta private e një personi ndikohet nga masa që zbatohen jashtë shtëpisë ose ambienteve private të tij ose të saj”.⁸ Në veçanti, GJEDNJ-ja në disa raste ka shqyrtuar “nëse individët kishin pritshmëri të arsyeshme se privatësia e tyre do të respektohej dhe mbrohej”.⁹ Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se elementet e jetës private marrin rëndësi edhe në rastet kur ka “përmbledhje të dhënash për një individ, përpunim ose përdorim të dhënash personale ose publikim të materialit përkatës, në një mënyrë ose shkallë përtej asaj që është normalisht e parashikueshme”.¹⁰

95. Avokati i Popullit rikujton se, me gjithë zbatimin e mundshëm të nenit 8 në ushtrimin e veprimtarive profesionale, zbatimi i këtij neni gjithmonë është kufizuar në ato masa që ndikojnë në privatësinë përtej asaj që është logjikisht e parashikueshme.

96. Në këtë rast, Avokati i Popullit vëren se ndonëse parashtruesi i ankesës ishte i punësuar kryesisht si [REDAKTUAR], në përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të vendit të tij të punës, përcaktohet se atij mund t’i kërkohej të kryente funksione hetimore të cilat, për nga natyra e tyre, me shumë gjasë, do të ishin objekt i nxjerrjes së informacionit.

97. Realiteti i situatës është se parashtruesi i ankesës ishte duke kryer rolin e një hetuesi kur ai përpiloi dokumentet që u nxorën për Mbrojtjen [REDAKTUAR]. Në këtë aspekt, Avokati i Popullit konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të tregojë, për shkak të postit që mbante ose elementëve të privatësisë, se deri në çfarë mase ai priste logjikisht që emri i tij të redaktohej në dokumentet e nxjerra për Mbrojtjen, në përputhje me dispozitat e rregullave 107 dhe 108 të RRPP-së.

98. Avokati i Popullit pajtohet se ZPS-ja nxjerr informacion për Mbrojtjen në mënyrë konfidenciale, që do të thotë se ai mund të përdoret për qëllime hetimore ose të gjyqimit, por nuk mund të bëhet publik dhe

⁷ *Shih p.sh.*, ECtHR, *Martínez v. Spain*, no. 56030/07, ECHR 2012, para. 109; *Özpinar v. Turkey*, no. 20999/04, ECHR 2010, para. 46; *Sidabras and Džiautas v. Lithuania*, nos. 55480/00 and 59330/00, ECHR 2015, para. 48

⁸ *Benedik v. Slovenia*, no. 62357/14, ECHR 2018, para. 101.

⁹ *Po aty.*

¹⁰ *Shih Satakunnan Markkinapörssi Oy and Satamedia Oy v. Finland* [GC], no. 931/13, ECHR 2017 para. 136.

Avokati i Popullit është bindur se kjo është kuptuar nga parashtruesi i ankesës.

99. Në fakt, parashtruesi i ankesës, në parashtrimet e tij për Avokatin e Popullit, është shprehur se: *“ishte plotësisht e parashikueshme që raportet që unë hartova do të ishin të rëndësishme. Në fakt, do të kishte qenë e pritshme që të jepja dëshmi, siç bëri pasuesi im. Megjithatë, unë do të kisha bërë kërkesë për masat mbrojtëse më të forta që identiteti im të mos i bëhej i ditur publikut...”*¹¹(theksimi i shtuar)

100. Avokati i Popullit konstaton se dhënia e emrit të parashtruesit të ankesës Mbrojtjes nuk përbën nxjerrje të identitetit të tij për publikun dhe është i bindur se ZPS-ja këtë e ka bërë në bazë të detyrimeve të veta ligjore për nxjerrjen e provave. Avokati i Popullit gjithashtu arrin në përfundimin se dhënia e këtij informacioni për Mbrojtjen është bërë mbi bazën e konfidencialitetit, siç përcaktohet në paragrafin 98 më lart.

101. Gjithashtu, Avokati i Popullit pajtohet me parashtrimin e Prokurorit të Specializuar se [REDAKTUAR] Vendimit Kornizë nuk zbatohet për parashtruesin e ankesës, dhe rrjedhimisht, sipas rregullave nuk kishte asnjë bazë për redaktimin e emrit të tij.

102. Lidhur me kundërshtimin e parashtruesit të ankesës ndaj kërkesës së Mbrojtjes për të marrë të dhënat e tij personale të kontaktit, Avokati i Popullit konstaton se nuk sheh problem në lidhje me këtë. Natyrisht, është e drejtë e Mbrojtjes të kërkojë një informacion të tillë nga Prokuroria, nëse e sheh të arsyeshme këtë gjë. Sidoqoftë, siç u bë e qartë në rastin konkret, ZPS-ja nuk ia dha këto të dhëna Mbrojtjes pas kërkesës së saj, por, përkundrazi, kërkoi të dinte pikëpamjet e parashtruesit të ankesës. Pasi parashtruesi i ankesës e njoftoi ZPS-në për refuzimin e tij, ZPS-ja nuk ia dha të dhënat e tij personale Mbrojtjes.

103. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se e drejta për jetë private, që mbrohet nga neni 36 i Kushtetutës, neni 8 i KEDNJ-së dhe neni 17 i KNDCP-së nuk zbatohet në rastin e nxjerrjes së emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet që i jepen Mbrojtjes, pasi parashtruesi i ankesës logjikisht nuk mund të presë që identiteti i tij të mos i jepet Mbrojtjes.

¹¹ Përgjigje e Parashtruesit të Ankesës ndaj Kërkesës për Informacion Shtesë, [REDAKTUAR], f.3.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është bindur se nxjerrja e identitetit ishte në përputhje me ligjin.

104. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të ankesës se nxjerrja e emrit të tij për Mbrojtjen mund të rrezikonte sigurinë e tij e të familjes së tij dhe mundësitë për të gjetur punë në të ardhmen, Avokati i Popullit thekson si vijon.

105. Lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtës për jetën të parashtruesit të ankesës dhe familjes së tij, neni 2 i KEDNJ-së *“mund të zbatohet edhe pse personi të cilit pretendohet se i është shkelur e drejta për jetën nuk ka vdekur [...] kur ekziston një rrezik real dhe i drejtpërdrejtë për jetën e individit”*.¹² (theksimi i shtuar)

106. Duke analizuar nëse nxjerrja e informacionit për Mbrojtjen ka shkaktuar rrezikim të sigurisë së parashtruesit të ankesës e të familjes së tij dhe të mundësive për të gjetur punë në të ardhmen, Avokati i Popullit vëren se nxjerrja për Mbrojtjen e emrit të parashtruesit të ankesës është bërë mbi bazën e konfidencialitetit. Asnjë nga të dhënat personale të parashtruesit të ankesës nuk u nxor nga ZPS-ja.

107. Në parashtrimet e tij, parashtruesi i ankesës shprehet se: *“Unë nuk pretendoj se mbrojtësi do të kishte bërë ndonjë gjë me keqdashje, por fakti që identiteti im nuk u mbrojt, mund të kishte çuar në nxjerrjen e tij për të tjerët. Edhe njëherë po them, ky nuk është një skenar i pamundur dhe mund të kishte ndodhur thjesht me vendosjen e një shënimi me të dhënat e mia mbi një tavolinë në sallën e gjyqit për t’u parë nga të tjerët”*¹³.

108. Avokati i Popullit me respekt e refuzon këtë pretendim dhe pajtohet se materiali i nxjerrë për Mbrojtjen është trajtuar në mënyrën e duhur në përputhje me ligjin dhe rregullat. Gjithashtu, Avokati i Popullit vë në dukje se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të provojë se identiteti i tij u zbulua faktikisht nga nxjerrja e tij për Mbrojtjen dhe pretendimin e tij e bazon t në hamendje.

109. Avokati i Popullit konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të provojë se nxjerrja e emrit të tij për Mbrojtjen ka çuar në shkeljen e të

¹² *Shih Selahattin Demirtaş v. Turkey*, no. 15028/09, ECHR 2015 para. 30-36.

¹³ Përgjigje e Parashtruesit të Ankesës ndaj Kërkesës për Informacion Shtesë, [REDAKTUAR], f.2

drejtës së tij dhe të familjes së tij për jetën, që mbrohet nga neni 25 i Kushtetutës së Kosovës, neni 2 i KEDNJ-së dhe neni 6 i KNDCP-së, pasi kjo gjë u bë në përputhje me ligjin dhe mbi bazën e konfidencialitetit.

110. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës se nxjerrja e emrit të tij për Mbrojtjen mund të kishte rrezikuar mundësitë e tij për të gjetur punë në të ardhmen, Avokati i Popullit konstaton se nxjerrja për Mbrojtjen e emrit të parashtruesit të ankesës u bë mbi bazën e konfidencialitetit. Si rezultat, Avokati i Popullit konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të provojë se nxjerrja e emrit të tij për Mbrojtjen ka çuar në humbjen e mundësive të punësimit për të.

111. Avokati i Popullit konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të provojë shkeljen e të drejtës së tij për jetë private dhe profesionale, që mbrohet nga neni 36 i Kushtetutës, neni 8 i KEDNJ-së dhe neni 17 i KNDCP-së.

VII. PËRFUNDIM

112. Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se pika e parë e ankesës, që ka të bëjë me nxjerrjen e emrit të parashtruesit të ankesës gjatë seancës publike, duhet të rrëzohet, në përputhje me rregullat 29(1), 29(3)(a) të RRPP-së.

113. Lidhur me pikën e dytë të ankesës, Avokati i Popullit është bindur se nxjerrja e emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet e dhëna Mbrojtjes nuk ka ndikuar në të drejtën për jetë private dhe për jetë private dhe profesionale të parashtruesit të ankesës, që mbrohen nga neni 36 i Kushtetutës së Kosovës, neni 8 i KEDNJ-së dhe neni 17 i KNDCP-së. Avokati i Popullit është po ashtu bindur se nxjerrja e emrit të parashtruesit të ankesës në dokumentet që i janë dhënë Mbrojtjes nuk ka ndikuar në të drejtën për jetën të parashtruesit të ankesës dhe familjes së tij, e cila mbrohet nga neni 25 i Kushtetutës, neni 2 i KEDNJ-së dhe neni 6 i KNDCP-së.

114. Për këto arsye, Avokati i Popullit arrin në përfundimin se ZPS-ja nuk ka shkelur të drejtat themelore të parashtruesit të ankesës.

VIII. REKOMANDIME

115. Pavarësisht nga konstatimet e mësipërme, Avokati i Popullit e gjykon të nevojshme të bëjë rekomandimet e mëposhtme për ZPS-në.

116. Së pari, në rastet kur një grupi të vogël punonjësish që mbajnë poste të një natyre konfidenciale u kërkohet të kryejnë detyra të tjera, zbatimi i të cilave ka të ngjarë të çojë në nxjerrjen e emrave të tyre, Avokati i Popullit është i mendimit se ZPS-ja duhet të kryejë një vlerësim objektiv të rrezikut për ata punonjës individualisht para çdo nxjerrjeje materialesh për Mbrojtjen. Ky vlerësim duhet të bëhet edhe për punonjësit e mëparshëm. Do të ishte e dobishme që punonjësve t'u vihej në dispozicion një udhëzues me shkrim në mënyrë që ata të jenë të qartë për këtë çështje.

117. Së dyti, Avokati i Popullit vëren se parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të dhënat e tij personale të fshihen nga dosjet me të dhëna të personelit që mbahen nga ZPS-ja DHSK-ja dhe EULEX-i. Ndonëse pajtohet se ZPS-ja nuk kontrollon asnjë nga të dhënat personale të parashtruesit të ankesës që mban EULEX-i, Avokati i Popullit rekomandon që kërkesa të rishqyrtohet si kërkesë për të dhënat personale dhe ZPS-ja të bashkëpunojë me punonjësin për mbrojtjen e të dhënave të Zyrës Administrative për të siguruar që kërkesa të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e të dhënave.

118. Së fundi, Avokati i Popullit mirëpret faktin që Prokurori i Specializuar pajtohet se baza arsyetuese e nenit 33(3) të Udhëzuesit të Punës së Zyrës Administrative mund të përfshijë edhe punonjës të mëparshëm dhe, në të ardhmen, do të angazhohet në mënyrë aktive që në seancat gjyqësore publike punonjësit e mëparshëm të përmenden duke iu referuar emërtimit të postit e jo me emër, me përjashtim të rasteve kur kjo është rreptësisht e domosdoshme, ose nëse urdhërohet nga gjykata.

/nënshkrimi/

Pietro Spera

Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës

E hënë, 22 shtator 2022
Në Hagë, Holandë.

